



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për :	Fadil Nura, Kryetar i Komunës së Skenderajt Adelina Spahiu, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Skenderajt	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, U.D. Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	Erbilin Hetemi, U.D. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL	Data: 18/04 /2024
Zyrtarët përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit të Monitorimit Driton Xhafa, Zyrtar për Monitorimin e Komunave	Nr. 020-254
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtim të ligjshmërisë së aktit të komunës së Skenderajt	
Lloji i aktit:	Vendimit	

I nderuar Kryetar,
E nderuara Kryesuese,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshim-plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim nr. 01-020/01-0016897/24 për themelimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale
I miratuar në komunë me datë : 28.03.2024
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 04.04.2024

Ministria e Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson së akti i komunës **është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.**

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e mbajtur me datën 28.03.2024 ka miratuar Vendim nr. 01-020/01-0016897/24 për themelimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale.

MAPL konstaton, se nxjerrja e Vendimit 01-020/01-0016897/24 neni dy (2) që përcakton "Përbërjen e komisionit" nuk e përmbushë kriterin bazë të përcaktuar në nenin 5 paragrafit 2 të Udhëzimit Administrativ nr. 02-2019 për Organizimin, Funkcionimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatra, Lagjet dhe Vendbanimet Urbane.

Udhëzimit Administrativ nr. 02-2019 në nenin 5 paragrafit 2 ka përcaktuar se "Komisioni duhet të ketë shtatë (7) anëtarë. Përbërja duhet të jetë katër (4) anëtarë nga kuvendi i komunës nga subjekte të ndryshme politike, një (1) anëtar nga ekzekutivi, një (1) nga shoqëria civile dhe një (1) përfaqësues nga fshati, vendbanimi apo lagjja urbane nga lokaliteti ku bëhet zgjedhja e këshillit lokal" që në rastin konkret anëtarët nga kuvendi i komunës së Skenderajt nuk janë të përfaqësuar nga subjekte të ndryshme politike ashtu si janë të përfaqësuar në kuvend.

Në Kuvendin e Komunës së Skenderajt janë të përfaqësuar pesë (5) etnitete politike ndërsa në Vendim nr. 01-020/01-0016897/24 janë të përfshirë vetë dy etnitete politike dhe kjo ka pamundësuar përfaqësimin e duhur në komisionin për koordinimin e zgjedhjeve të këshillave lokale.

Bazuar në të lartcekurat Kuvendi i Komunës së Kamenicës duhet të ndërmerr veprime dhe brenda afatit ligjor të rishqyrtoj aktin dhe të harmonizoj më legjislacionin në fuqi.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za :	Fadil Nura, gradonačelnik opštine Srbica Adelina Spahiu, predsedavajuća Skupštine opštine Srbica
Kopija:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini
Preko:	Elbert Krasniqi, ministar MALS-a Jeton Qela, v.d. generalnog sekretara MALS-a.
Od:	Erbilin Hetemi, v.d. rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MALS
Službenik-ca za potvrđivanje pravne procene:	Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština
Službenik-ca za izradu pravne procene:	Driton Xhafa, službenik za monitorisanje opština
Predmet:	Zahtev za reviziju akta Skupštine opštine
Vrsta akta:	Odluka Skupštine opštine Srbica

Poštovani gradonačelnice,
Poštovana predsedavajuća,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosovo br. 10/2019 o administrativnom razmatranju akata opština, kao i Uredbom br. 06/2021 o izmeni i dopuni Uredbe (VRK) br. 10/2019, o administrativnom razmatranju akata opština, a na osnovu zakonskih ovlašćenja ministarstva utvrđenih osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 14/2023 o oblastima i administrativnim odgovornostima Kancelarije premijera i ministarstava, Pravno odeljenje i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi sledeći opštinski akt:

Odluka br. 01-020/01-0016897/24 o uspostavljanju komisije za izbor seoskih naselja

Usvojena dana, 28.03.2024.

Podnešena na razmatranje u MALS-u dana, 04.04.2024.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, ocenjuje da je akt opštine u suprotnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.

Obrazloženje

Skupština opštine Srbica, na sednici održanoj dana, 28.03.2024. godine, usvojila Odluku br. 01-020/01-0016897/24 o uspostavljanju komisije za izbor seoskih naselja.

MALS konstatuje da donošenje Odluke br. 01-020/01-0016897/24, član 2. koji utvrđuje da: "Sastav komisije" ne ispunjava osnovni kriterijum koji je utvrđen članom 5, stav 2 Administrativnog uputstva br. nr. 02-2019 za organizovaje, funkcionisanje i saradnji opštine sa selima, naseljenim mestima i urbanim naseljima.

Administrativno uputstvo br. 02-2019 u članu 5, stav 2 utvrdio da „Komisija mora imati sedam (7) članova. Sastav mora biti četiri (4) člana Skupštine opštine iz različitih političkih subjekata, jedan (1) odbornik iz izvršne vlasti, jedan (1) iz civilnog društva i jedan (1) odbornik iz sela, naselja ili gradskog naselja iz lokaliteta u kome se vrši izbor lokalnog veća“ da u ovom konkretnom slučaju odbornike iz skupštine opštine Srbica ne predstavljaju različiti politički subjekti kao što su predstavljeni u skupštini.

U Skupštini opštine Srbica, zastupljeno je (5) političkih etničkih grupa, dok je u Odluci br. 01-020/01-0016897/24 uključene su dve političke etničke grupe i to je onemogućilo odgovarajuću zastupljenost u komisiji za koordinaciju izbora mesnih saveta iz redova Skupštine.

Na osnovu gore navedenih, Skupština opštine Srbica treba preduzeti mere unutar zakonskog roka da revidira i usklađuje akt sa zakonodavstvom na snazi.